



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 07, datë 22.02.2017

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“STRUKTURA SHËRBIMI ME FUNKSION MAGAZINIMI DHE TREGTIMI 1-2 KATE
“MALL OF TIRANA”,
ME VENDNDODHJE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KASHAR, BASHKIA TIRANË”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “Concord Investment” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Struktura shërbimi me funksion magazinimi dhe tregtimi 1-2 kate “Mall of Tirana”, me vendndodhje në Njësinë Administrative Kashar, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues “Concord Investment” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet e Lejes së Ndërtimit do t'i jepen subjektit kërkues për secilën nga fazat të përcaktuara në hartën bashkëlidhur, vetëm pas:
 - konvertimit të zërit kadastral nga “arë” në “truall” sipas legjislacionit sektorial në fuqi;
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEFARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

